




PRISHTINË, Rr.UÇK nr.2 ,tel. 038249616
E-mail:shiluck99@hotmail.com



REAGIM PUBLIK

NDAJ VENDMIT TE KRYMËMINISTRIT

Për rregullimin e protezave për Invalidët e Luftës së UÇK-së

Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së , e kundërshton fuqishëm vendimin e Kryeministrit nr.10/16 datës 03.02.2021, qe Klinika e Ortopedisë në SHSKUK te bëjë furnizimin dhe rregullimin e protezave për Invalidët e Luftës së UÇK-së .

I bëjmë thirrje z. Avdaullah Hoti,kryeministër në detyrë ,qe ta shqyrtoje vendimin e lartpërmendur sepse ne mendojmë dhe jemi shume te sigurt qe Klinikat tona nuk kanë kapacitete teknike qe ta bëjnë një gjë te tillë , madje nuk kemi as specialist te kësaj fushe .

Qasja e juaj kryeministër karshi invalidëve të luftës është gabim sepse buxheti i shtetit nuk duhet te t'kurret ne protezat e atyre qe i lanë gjymtyrët e trupit në luftë , kemi ushtarë të UÇK-së qe i ka humbur dy këmbët e tij mbi gju dhe ka nevojë për dy proteza , kemi invalid qe në luftë i ka humbur dy sytë dhe tash ka nevojë për dy proteza te syve, Invalid të tillë i kemi mbi 100 persona qe kanë nevojë për proteza ,

Protezat e Invalidëve janë bërë jashtë Kosovës mbulimin e shpenzimeve e kanë bërë gjithmonë Qeveritë e Kosovës , andaj shqyrtoje vendimin për proteza përndryshe këta invalid me gjymtyrët e humbura ne luftë dhe protezat e amortizuara, do te protestojnë javën qe vjen para zyrave tuaja .

Prishtinë
05 .02.2021



SHIL të UÇK-së
Sekretar Enver Krasniqi